

KONTRATË SHITJE AKSIONESH TE KAPITALIT

TË SHOQËRISË “DEUTSCHCOLOR” SHA

Sot me datë 19/02/2024, aksionari i shoqërisë DEUTSCHCOLOR SHA Luan Muça dhe perfaqesuesi i shoqërisë DC Industries Luan Muça u mbledhen për të nënshkruar kontratën e shitjes së aksioneve ku:

SHITESI:

Luan Muça, i datelindjes 05.08.1971 pajisur me kartën e identitetit H10805062A, zoterues i 100 aksioneve që i korrespondojnë 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 48 438 379 leke.

BLERESI:

Shoqëria “DC Industries” shpk, shoqëri tregtare, e regjistruar pranë QKB me datë 29.08.2023, me NUIS, M32031012N, e perfaqësuar nga administratori i saj Z. Luan Muça i datelindjes 05.08.1971 pajisur me kartën e identitetit H10805062A.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nëni 705 e vijues I tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord të nënshkruajnë Kontratën e Shitjes të kësaj lloji të kapitalit të Shoqërisë “DEUTSCHCOLOR” SHA, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, nëni 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

Neni 1

Marreveshja themelore

Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” SHA, është regjistruar me Nipt L21326504J, me seli: VLASHAJ Autostrada Tiranë - Durrës, Zonë Kadastrale 3796, Durrës, me aksionar të vetëm

Luan Muça zoteruesi 100 aksioneve ekuivalente me 100% të kapitalit me vlerë 48 438 379 leke.

Ne vendimin datë 15.02.2024, asambleja e aksionarit të vetëm të shoqërisë ka miratuar shitjen e aksioneve të zotëruara nga pala shitese Luan Muça në favor të palës blerese Shoqëria “DC Industries” shpk, perfaqësuar nga administratori i saj Luan Muça dhe konkretisht:

Pala shitese Luan Muça i shet palës blerese shoqërisë “DC Industries” shpk, perfaqësuar nga administratori i saj Luan Muça 100 aksione që perfaqësojnë pjesëmarrjen në përqindje 100% të kapitalit të shoqërisë “DEUTSCHCOLOR” SHA.



Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe menyra e likujdimit

Çmimi i plotë i shitjes së aksioneve është 48 438 379 leke si me poshte:

Luan Muça ka rene dakort ti shesi pales blerese shoqerise “DC Industries” shpk, perfaqesuar nga administratori i saj Luan Muça nëpërmjet shitjes se 100 aksioneve qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise, kundrejt cmimit 48 438 379 leke shume e cila eshte likujduar nga pala blerese ne favor te pales shitese.

Pas ketij veprimi, shoqeria do do te kete 100 aksione qe do te zoterohen nga ortaku si me poshte:

Shoqeria “DC Industries” shpk, zoteruesi i 100 aksione ekuivalente me 100% te kapitalit me vlere 48 438 379 leke.

Neni 3

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kontrata do te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa kalimi i pronësisë së ligjshme mbi aksionet nga Shitësi te Blerësit do të kryhet menjehere.

Neni 4

Garancitë

Shitësi në lidhje me aksionet që zotëron, garanton Blerësin:

- 1.Se është pronar i aksioneve të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të optionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuota te shitura.
- 2.Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi aksionet e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
- 3.Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
- 4.Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas



ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave , veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

5. Pala shitesë me nënshkrimin e kësaj kontrate, heq dorë perfundimisht nga pronësia mbi aksionet që shet, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kalojnë palës blerëse.

Neni 5

Regjistrimi

Regjistrimi i kontratës për kalimin e aksioneve nga Shitësi të Blerësit në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 7

Dispozitat e fundit

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kontrata redaktohet në dy kopje origjinale konform rregullave dhe ligjeve dhe me vullnet të lirë nënshkruhet nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI

Luan Muça



BLERESI

Shoqëria “DC Industries” shpk
Perfaqësuar nga administratori Luan Muça

